**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA PUKË**
**KËSHILLI BASHKIAK**
**Komisoni i Përhershëm për Ekonomi dhe Financë**

# RAPORT VENDIMMARRJE

**Nr.3 datë 16-10-2025**

***Drejtuar:*** Këshillit të Bashkisë
***Lenda:*** Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 6 datë 30/09/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin "Projekt-Vendim Per miratimin e anekseve te monitorimit te buxhetit, 4-mujori i dyte i vitit 2025"

**Analiza ligjore**: Në mbështetje të ligjit 139/2015" Për vetëqeverisjen vendore" në ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"
Në ligjin nr 68/2017 në ligjit nr 115/2024.Udhëzimit nr 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", udhëzimit nr 2 datë 24.01.2025 "Për zbatimin e buxhetit vitit 2025", udhezimit nr 22 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të minitorimit të buxhetit të njësive të vetqeverisjes vendore" VKB nr 64 datë 27.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025, vkb nr 08 datë 25.02.2025 "Për miratimin e fondeve të trashëguara nga buxheti i vitit 2024 për buxhetin e vitit 2025

**Situata aktuale dhe financiare e funksionit:**
Detajimi i buxhetit për vitin 2025 është bere bazuar në ligjin Nr.139/2015 Për vetëqeverisjen vendore", ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ligjin 68/2017 date 27.4.2017 "Per financat e vetëqeverisjes vendore", ne ligjin 97/2023 "Per buxhetin e vitit 2024", udhëzimin nr 9 date 20.03.2018"Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" udhezimit plotesues nr.1, date 24.01.2024 "Per zbatimin e buxhetit te vitit 2024", VKB nr.64 datë 27.12.2024 konfirmuar Prefektura Nr 28/1 date 14.01.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025, vkb nr.8, datë 25.02.2025 konfirmuar Prefektura Nr. 187/1 date 13.03.2025 "Për miratimin e fondeve te trasheguara ( pjesore), nga buxheti i vitit 2024, per vitin 2025", Programi Buxhetor Afatmesëm parashikon një mbulim sa më të plotë të territorit me shërbime publike cilësore me qëllim përmirësimin e jetesës së qytetarëve; përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës rrugore urbane dhe asaj rurale, përmirësimin e shërbimit të pastrimit në të gjithë territorin, rritjen e sipërfaqeve të gjelbërta;ndërtimin dhe mirëmbajtjen e tregjeve të reja; përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe aksesit; mbështetjen e iniciativave për zhvillimin e zonave të përmirësimit të biznesit; mbrojtjen e tokave bujqësore, reabilitimin dhe investimin e infrastrukturën bujqësore, promovimin dhe marketingun e produkteve bujqësore; mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, përmirësimin e sistemit të edukimit dhe trajnimit profesional, sigurimin e kushteve sa më dinjitoze për fëmijët dhe të rinjtë mbulimin e territorit me

shërbime sociale sipas nevojave të komunitetit; zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive; sigurimin e mbrojtjes civile dhe menaxhimin e katastrofave në të gjithë territorin e Bashkisë Pukë; Zbatimi i Programit Buxhetor Afatmesëm është një instrument i rëndësishëm për përmirësimin e cilësisë së jetës, përmirësimin e aksesit, integrimin territorial dhe barazinë në shërbime, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, rritjen e cilësisë së jetesës, dhe mbrotjen e mjedisit duke e kthyer Pukën në një qendër të përparuar social ekonomike.
Hartimi i dokumentit te buxhetit për vitin 2025 u bë në 18 programe, 24 funksione dhe ne nivel produkti per secilin program.
I-Realizimi I Buxheti te Bashkisë për vitin 2025 4-mujorin e dytë (janar - gusht)

Me poshte tabela e shpenzimeve per 4 mujorin e dyte.

ne 000/leke

| Emri i Grupit | BASHKIA PUKË | | | | Kodi i Grupit | 2137001 | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Programet | | Shpenzimet e Ministrisë/Institucionit | | | | | | |
| | | (1) | (2) | (3) | (4) | (5) | (6) | (7)=(6)-(5) |
| Titulli | Emertimi | Fakti i vitit paraardhes Viti 2024 | PBA Viti 2025 | Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2025 | Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2025 | Buxheti Vjetor Plani i Periudhes /progresiv | Fakti i Periudhes /progresiv | Diferenca |
| 01110 | Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi | 83,888 | 112,566 | 112,566 | 114,558 | 114,558 | 72,670 | (41,888) |
| 03140 | Shërbimet e Policisë Vendore | 4,624 | 5,150 | 5,150 | 5,250 | 5,250 | 3,586 | (1,664) |
| 03280 | Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile | 22,328 | 31,618 | 31,618 | 38,018 | 38,018 | 23,011 | (15,007) |
| 04130 | Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik | - | - | - | - | - | - | - |
| 04240 | Menaxhimi i Infrastruktuës së Ujitjes dhe Kullimit | 3,873 | 6,825 | 6,825 | 8,521 | 8,521 | 784 | (7,737) |
| 04520 | Rrjeti Rrugor Rural | 13,159 | 15,219 | 15,219 | 15,946 | 15,946 | 7,278 | (8,668) |
| 05100 | Menaxhimi i Mbetjeve | 11,695 | 11,595 | 11,595 | 11,595 | 11,595 | 6,812 | (4,783) |
| 06260 | Shërbimet Publike Vendore | 83,047 | 62,659 | 62,659 | 112,177 | 112,177 | 57,607 | (54,570) |
| 04260 | Administrimi i pyjeve | 18,207 | 22,419 | 22,419 | 26,100 | 26,100 | 14,815 | (11,285) |
| 06370 | Furnizim me Uje | 26,606 | - | - | 3,858 | 3,858 | - | (3,858) |
| 08130 | Sport dhe Argëtim | 23,574 | 20,288 | 20,288 | 20,586 | 20,586 | 17,830 | (2,756) |
| 08220 | Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike dhe Kulturore | 6,119 | 8,353 | 8,353 | 8,653 | 8,653 | 4,759 | (3,894) |
| 09120 | Arsimi Bazë përfshirë Parashkollorin | 51,210 | 64,024 | 64,024 | 72,545 | 72,545 | 37,199 | (35,346) |
| 09230 | Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm | 24,247 | 27,561 | 27,561 | 33,758 | 33,758 | 15,562 | (18,196) |
| 10430 | Cerdhja ditore | 10,390 | 11,703 | 11,703 | 12,600 | 13,761 | 9,112 | (4,649) |
| '10430 | Përkujdesi Social | 115,010 | - | - | 52,071 | 84,381 | 56,775 | (27,606) |
| 10661 | Strehimi Social | 3,878 | 6,500 | 6,500 | 6,500 | 6,500 | 2,632 | (3,868) |
| 04940 | Fond Rezerve dhe kontigjence | 218 | 2,000 | 2,000 | 3,000 | 3,000 | - | (3,000) |
| 10910 | Emergjenca Civile | 2,808 | - | - | 5,397 | 5,398 | - | (5,398) |
| 01170 | Gjendja civile | 3,431 | - | - | 3,317 | 3,662 | 2,645 | (1,017) |
| 09120 | Arsimi Baze | - | - | - | 15,384 | 15,384 | - | (15,384) |
| 01620 | Zgjedhjet e pergjithshme lokale | - | - | - | 70 | 1,056 | 935 | (121) |
| Totali i Shpenzimeve te Ministrise | | 508,312 | 408,478 | 408,478 | 569,904 | 604,707 | 334,012 | (270,695) |
| Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit | | - | - | - | - | - | - | - |
| Totali | | 508,312 | 408,478 | 408,478 | 569,904 | 604,707 | 334,012 | (270,695) |

**Drejtoria / Sektori përgjegjës**:
Drejtoria e Financës ka relatuar përpara komisionit për miratimin e projektvendimit

**Monitorimi dhe raportimi :** Komisioni i Ekonomisë dhe Financave dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme drejtorinë e Finances ose Drejtorinë përgjegjëse për informacione te tjera te nevojshme.
**Impakti social / grupet që preken:** Dokumenti i propozuar ndikon ne jeten e gjithe banoreve te Bashkisë.
Komisioni i Përhershëm për " Ekonomi dhe Financë", i mbledhur me datën 16/10/2025, shqyrtoi projekt vendimit nr.6 datë 08/10/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Projekt-Vendim Per miratimin e anekseve te monitorimit te buxhetit, 4-mujori i dyte i vitit 2025" paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,
Komisioni me shumicë votash,

**VENDOSI**

1. T’i propozojë Këshillit Bashkiak:
   a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
   b) miratimin e projektaktit

________________________________ **Kryetar i Komisionit**
*(emri, mbiemri, firma)*

________________________________ **Sekretar i Komisionit**
*(emri, mbiemri, firma)*

Datë 16.10. 2025